



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1279/7 Prot.

Tiranë, më 26.12.2023

**V E N D I M**

Nr. 253, datë 26.12.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 248, datë 20.11.2023<sup>1</sup>, e Gj.P kundër Shkollës 9-vjeçare “Kushtrimi i Lirisë”, Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “përgjegjësisë prindërore<sup>2</sup>”, “përkatësisë prindërore<sup>3</sup>” dhe “moshës<sup>4</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe në shkresën datë 07.12.2023, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Jam në proces divorci afër tre vjet me bashkëshorten time të quajtur L.P. Gjykimi i çështjes nuk është mbyllur për arsye të mungesës së gjyqtarëve dhe

<sup>1</sup> Ankesa është plotësuar me shkresën datë 07.12.2023.

<sup>2</sup> Në lidhje me Përgjegjësinë prindërore unë si prind kam një sërë të drejtash dhe detyrimesh ndaj fëmijëve të mitur të cilat më janë mohuar, për tu siguruar fëmijëve një mirëqenie emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës duke u kujdesur për to, për të mbajtur raporte vetjake me ta, duke i siguruar atyre mirërritjen, edukimin, arsimimin, të drejta të cilat më janë mohuar nga ana e Drejtoreshës. Unë si prind ndonëse jam në gjykim (nuk ka përfunduar ende procesi) paguaj pension ushqimor vullnetarisht duke ja depozituar bashkëshortes në Bankë. Po ashtu u blej rroba, etj, dhe përsëri unë nuk gëzoj asnjë të drejtë për tu informuar, për të marrë informacion për gjendjen e tyre, apo dhe për ti takuar, etj.

<sup>3</sup> Në lidhje me përkatësinë prindërore nga ana e Drejtoreshës të Shkollës “Kushtrimi i Lirisë”, unë nuk njihem si prind i fëmijës A dhe A. P, pasi nuk jam njoftuar asnjëherë prej drejtorisë së kësaj shkolle: - Për të marrë pjesë në mbledhjet e prindërve për tu informuar mbi ecurinë e gjendjes arsimore? - Nuk jam njoftuar asnjëherë në lidhje me gjendjen shëndetësore të fëmijëve pasi si prind i tyre informacionin duhet ta kem permanent për shkak të moshës së tyre?

<sup>4</sup> Në lidhje me moshën e fëmijëve rezultoi se ata janë të mitur dhe nga qëndrimi diskriminues që më bëhet mua si prind i tyre, këtyre fëmijëve u krijohet një traumë e madhe për të cilën pasojat vijnë në vazhdim.

aktualisht në fazën që ne ndodhemi jemi akoma familjar. Nuk kam asnjë urdhër mbrojtje apo kallëzim ndaj fëmijëve apo bashkëshortes. Kam të drejtë si çdo prind të takoj dhe të marr fëmijën.

Në datë 27.09.2023 shkova të interesohem dhe të takoj djalin dhe gjëja e parë që u përballa ishte roja i shkollës ku më tha se nuk kam për të hyrë se i është dhënë urdhër nga nëna e fëmijëve duke i thënë se boll e ke takuar vjet, këtë vit nuk do e takosh më. Roja më tha nuk dua probleme dhe nuk të lejoj dot dhe për çdo rast më ka thënë se ai deklaroi fjalët që i ka thënë nëna e fëmijëve L.P, ndërkohë ka hyrë nëndrejtori i shkollës dhe i ka thënë, pse nuk e lejon përderisa fëmija e do dhe oficeri i sigurimit të shkollës nuk ishte në kundërshtim, ndërsa roja ka thënë se pa më dhënë urdhër drejtoresha nuk mundem, pasi nuk dua probleme. Kam pritur drejtoreshën dhe në bisedë e sipër më ka thënë nuk lejohet të hysh në shkollë në orarin e mësimin, ndërkohë që më ka pritur tek porta, as në zyrë dhe i kam thënë se cila është arsyeja dhe a mundem se jam babai i fëmijës dhe dua ta takoj në orarin e pushimit ose në mëngjes në oborrin e shkollës, pasi jam babai i fëmijës sepse nuk dua të përballem me mamanë e fëmijës, pasi është shumë e acaruar dhe nuk dua të kem probleme me kallëzimet apo ndonjë problematikë tjetër. I kam kërkuar në mëngjes dhe më ka thënë se nuk e di se kur vjen dhe në drekë nuk lejohet të hysh pa një vendim gjykatë. E pyeta se si ka mundësi që fëmijët janë regjistruar në shkollë pa dijeninë dhe firmën time dhe mu përgjigj se është bërë kërkesa nga e-albania. I kam thënë që jam babai i fëmijës dhe nuk mund të më pengosh ta takoj. Fëmija është i vogël dhe shumë i lidhur mbas meje dhe mund të kalojë ndonjë traumë dhe unë po ashtu dua të kem informacion për ecurinë dhe shëndetin e tij.

I kam kërkuar rregulloren e shkollës dhe ma ka dërguar me email, ku nuk shoh asnjë pikë që të pengojë prindin të interesohet apo ta takoj në momentin që rregullorja nuk e përmban këtë gjë, ndërkohë që drejtoresha duhet të caktoj një orar që unë të kem takim me djalin në prani të psikologut apo asistentit social dhe mësuesen kujdestare, në një orar të caktuar, që e vendos drejtoresha. Kjo për mua është një diskriminim dhe kërkoj një ballafaqim ose marrjen e masës ndaj drejtoreshës B.B që të më mundësohet takimi me fëmijët”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, të informohet nga shkolla për çdo situatë në lidhje me fëmijët dhe takim me fëmijët.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatesinë prindërore, përgjegjësinë prindërore,

*moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 33, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen dhe ka kërkuar nga subjekti ankues shpjegime dhe dokumentacion plotësues.

- Për këtë arsye, me e-mail-in, datë 30.11.2023, inspektori i çështjes, ka kërkuar nga subjekti ankues që të paraqesë informacionin lidhur me shkaqet e diskriminimit dhe kopje të vendimit të Gjykatës që është në process divorci.

Subjekti ankues me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 1279/3, datë 07.12.2023, dërgoi shpjegime dhe dokumentacionin e kërkuar.

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1279/4, datë 12.12.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar Shkollën “Kushtrimi i Lirisë” Tiranë, për ankesën e bërë nga Gj.P dhe kërkoi dokumentacionin si më poshtë:
  - Kopje të plotë të procedurës së regjistrimit të nxënësit A.P në klasën e I-rë.
  - Informacion, përse nuk është njoftuar prindi për takim me prind dhe ecurinë e fëmijëve në shkollë.
  - Arsyet përse nuk lejohet Gj.P të takohet me fëmijët e tij.

Në vijim, subjekti ankues, nëpërmjet e-mail-it të datës 20.12.2023, të dërguar në adresën e inspektorit të çështjes, ka kërkuar të tërhiqet nga ankesa, pasi çështja e lejimit për takim dhe

informim për fëmijët ka gjetur zgjidhje, pas shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar me nr. 3275/1, datë 13.12.2023<sup>5</sup>.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Në nenin 90/3 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94<sup>6</sup>/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Gj.P, i cili, me anë të kërkesës të përcjellë nëpërmjet e-mail-it datë 20.12.2023, është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa e paraqitur nga subjekti ankues në datën 20.12.2023, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës nr. 248, datë 20.11.2023, të paraqitur nga Gj.P kundër Shkollës 9-vjeçare “Kushtrimi i Lirisë”, Tiranë, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

---

<sup>5</sup> DPAP në shkresën drejtuar ZVAP Tiranë dhe Shkollës 9-vjeçare “Kushtrimi i Lirisë” ka informuar se: “Shkolla “Kushtrimi i Lirisë”, të lejojë dhe mos krijojë pengesa për të takuar fëmijën e tij Gj.P, sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi”.

<sup>6</sup> “Tërheqja e ankesës”.

## **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 248, datë 20.11.2023, të Gj.P kundër Shkollës 9-vjeçare “Kushtrimi i Lirisë”, Tiranë, pasi ankuesi është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së, duke konsideruar se është arritur efektiviteti për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**